



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 korrik 2014
Nr.ref.:RK677/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI38/14

Parashtrues

Gani Balaj

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, AC-II-12-0165, të 10 tetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Gani Balaj, me vendbanim në fshatin Irzniq, komuna e Deçanit (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi i kërkesës) dhe i përfaqësuar nga z. Hasan Shala, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme), AC-II-12-0165, të 10 tetorit 2013, i cili i është dorëzuar atij në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se *“[...] i janë shkelë të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut (Neni 3 i Konventës)”*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe në nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 mars 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 1 prill 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 7 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë dokumente shtesë:
 - a. Autorizimin për z. Hasan Shala;
 - b. Fletëkthesën që tregon datën e dorëzimit të Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme, AC-II-12-0165;
 - c. Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme, SCC-07-0425, të 10 dhjetorit 2007.
8. Më 7 maj 2014, Gjykata ua dërgoi Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) nga një kopje të kërkesës.
9. Më 22 maj 2014, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj Gjykatës dhe dorëzoi autorizimin dhe Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme, SCC-07-0425, të 20 nëntorit 2007. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar në Gjykatë fletëdërgesën lidhur me datën e dorëzimit të Aktgjykimit AC-II-12-0165, sepse ajo është në Gjykatën Supreme.

10. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi Gjykatën me shkrim për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor – korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë lidhur me pretendime të caktuara të ngritura kundër tij.
11. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI38/14, e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu me gjyqtarin Ivan Čukalović, si anëtar i Kolegjit shqyrtues.
12. Më 26 qershor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Dhomën e Posaçme për të vërtetuar pronësinë mbi pronën.
14. Më 10 dhjetor 2007, Dhoma e Posaçme (Aktvendimi SCC-07-0425) e drejtoi rastin në Gjykatën Komunale në Deçan. Ky aktvendim nuk ishte dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës.
15. Më 23 mars 2009, Gjykata Komunale në Deçan (Aktgjykimi C. nr. 93/07) e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës për vërtetimin e pronësisë mbi pronën, si të pabazuar. Gjykata Komunale konstatoi se *“Me nenin 33 të Ligjit mbi Mardhënjet Themelore Juridiko Pronësore është përcaktuar se në bazë të punës së vlefshme juridike fitohet e drejta e pronësisë në palujtshmëri në librin publik ose në mënyrë tjetër përkatëse të përcaktuar me ligj [...]”*. Më tutje thuhet se *“[...] “Palujtshmëria tani kontestuese figuron në emër të të paditurës që nga viti 1956 me reambulim, gjersa padit[si edhe pas aeroinqizirnit si pretendues i të drejtës pronësore në palujtshmerin tani kontestuese, ka pasur afatin e mjaftueshëm kohor që ta kontestoj aeroinqizimin të cilën gjë edhe ne afatin kohor nuk e ka bere”*. Gjykata Komunale konkludon se *“Bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike, [...] se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar[...]”*. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër këtij aktgjykimi.
16. Më 10 tetor 2013, Dhoma e Posaçme (Aktgjykimi AC-II-12-0165) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Deçan. Dhoma e Posaçme konstatoi se:

“Kolegji i Ankesave [Dhoma e Posaçme] konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Deçan nuk është marrë me asnjë shkelje procedurale, për të cilat pretendon paditësi, andaj si i tillë ai është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe Kolegji i Ankesave e vërteton. Me këtë aktgjykim, gjykata ka bërë konstatimin e plotë të gjendjes faktike, me aq sa i është afruar nga paditësi me kërkesëpadi dhe me parashtrësar tjera me radhë, sepse barra e të provuarit, konform nenit 7 të LPK-së, bie mbi paditësin.

Me ankesën e tij, paditësi nuk ka afruar ndonjë prove bindëse për kundërshtimet e tij, pos parafrazimit të atyre që ishin thënë në kërkesëpadi.

Gjykata me këtë aktgjykim ka vërtetuar se prona kontestuese për një kohë të gjatë është në pronësi shoqërore, që do të thotë se pronare e kësaj prone është e paditura. Nëse ka pasur ndonjë cenim të të drejtës eë pronës, ashtu siq pretendon paditësi, nga e paditura, paditësi këtë ka mund ta parashtroj para organeve gjyqësore edhe me herët, por këtë nuk e ka bere asnjëherë, deri ne ngritjen e padisë, më 18 tetor 2007. Kjo heshtje për pengesat eventuale, ka pasojë edhe humbjen e mundësisë për ta kërkuar një të drejtë, edhe nëse ajo ekziston. Në bazë të nenit 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar (Gaz. Zyrt e RFSJ-së, 53/65), "nëse pasuria e paluajtshme është bere pasuri publike pa bazë ligjore, mund të ngritet padi për kthimin e saj brenda 5 vjetësh, nga data kur është mësuar për te, por jo më shumë se 10 vjet nga ajo ditë".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "Kooperativa Bujqsore "Përparimi" [...] e ka mbajtë arbitrarisht këtë pjesë duke cenuar ligjet në fuqi nga neni 9 dhe 10 të Ligjës së RSFJ me Nr. 6/1980, i aplikueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 të 12 dhjetorit 1999".
18. Parashtruesi më tej pretendon se "[...] bazuar në Ligjin Nr. 6/1980 të RSFJ-së mbi marrëdhëniet juridiko pronësore, neni 37 parasheh "Mbrojtëja e të drejtës së pronës së paluajtshme për parashtrimin e padisë në Gjykatë nuk parashkruhet". Bazuar në këtë, parashtruesi i kërkesës konsideron se prona ishte okupuar në mënyrë arbitrare nga Komuna dhe se ky ligj është shkelur pa kurrfarë baze juridike.
19. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se "Gjykata e shkalles së dytë, Kolegji i Dhomës së Posaqme i ka përsëritur të njëjtat cenime të Ligjes sikurse ajo e shkalles së parë sepse, pa mbajtje të shqyrtimit kryesor dhe pa kërkuar prova plotsuese nga pala paditëse e ka vendosur këtë qështje, kështu që paditësit nuk i është dhen mundësija që plotësisht ta argumentoi kërkesëpadinë para Kolegji të Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Aktgjykimi i Dhomës së Posaqme si gjykatë e shkalles së II-të është kontradiktor me arsyetimin e vet, kur e legjitimon dhe e vërteton aktgjykimin e atakuar me te njëjtat cenime të Ligjes të cilat i ka shkaktuar Gjykata e shkalles I-rë ne Deçan".

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh se "Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".

22. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) b) i Rregullores së punës parasheh se “(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi”.
23. Gjykata vëren se Aktgjykimi i fundit, AC-II-12-0165, i Dhomës së Posaçme, ishte nxjerrë më 10 tetor 2013 dhe i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës në një datë të pacaktuar, ndërsa parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 3 mars 2014. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar në Gjykatë dëshmi se kur i ishte dorëzuar atij aktgjykimi i Dhomës së Posaçme. Prandaj, kjo Gjykatë e konsideron datën e publikimit të vendimit 10 tetorin 2013, si datë të dorëzimit të vendimit të parashtruesi i kërkesës.
24. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është e paafatshme dhe në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b), ajo duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit, me rregullin 36 (1) b) dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 26 qershor 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani